



Pranuar / Dorezuar Prilimno/Prodato Received/Delivery	21.07.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKUPITARI	5328	2023	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.821/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi - anëtare, me Kaltrina Abdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.821/2023 të datës 07.06.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë,

_____ kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike" *kërkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.ref:191/2023 i datës 02.06.2023 i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

II. OBLIGOHET Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale ligjore për ta *rishqyrtuar* lëndën e ankuesit _____ duke u bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje .

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pozitën Zyrtar i lartë për Trajnim dhe Zhvillim sipas Akt emërimit të datës 16.01.2017, me Vendimin më numër ref.362/2020 të datës 14.07.2020 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), i ipet grada diplomatike Ministër Këshilltar dhe caktohet të shërbej në Ambasadën e

Republikës së Kosovës në Romë /Republika e Italisë me mandat katër (4) vjeçar, duke filluar nga data 01.09.2020.

Më tutje, ankuesi me Vendimin me numër nr.785/2020 të datës 07.10.2020, të Ministres të MPJD-së me gradën Ministër –Këshilltarë autorizohet që për nevoja të Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës të ketë qasje në Arkivin e Shtetit të Vatikanit dhe Arkivat e Shtetit të Italisë.

Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 16.03.2023 merr Vendim me numër Nr.Ref.216/2023, sipas të cilit ankuesin me gradën diplomatike Ministër Këshilltar, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë/Itali e kthen/tërheq nga misioni diplomatik nga data 01.05.2023.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin e Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër Nr.ref:216/2023, të datës 16.03.2023 lidhur me tërheqjen dhe kthimin e tij nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Romë/Itali, me datën 27.03.2023 përmes emailit ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3006/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me datë 08.05.2023 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin Anr.562/2023 me numër protokolli 4143/2023, me të cilin e ka shfuqizuar Vendimin me numër Nr.ref: 216/2023 të datës 16.03.2023 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke obliguar Zëvendës Kryeministren dhe Ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndër marrë veprimet procedurale për ta rishqyrtuar lëndën e ankuesit në afatin prej 15 ditësh.

Në zbatim të Vendimin me numer Anr.562/2023 të datës 08.05.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 31.05.2023 ka nxjerrë Vendim me numër Nr.Ref:339/2023 dhe të protokolluar me numër 2294 datë 01.06.2023, me të cilin vendim përmes pikës 1 të këtij vendimi ka shfuqizuar Vendimin më numër ref.362/2020 të datës 14.07.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për caktimin e ankuesit që të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë /Republika e Italisë, me që rast përmes këtij vendimi i njëjti është kthyer nga misioni, njëkohësisht duke e obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ta sistemoj brenda MPJD-së, ndërsa përmes Vendimit Nr.ref:191/2023 të datës 02.06.2023, i protokolluar me numër 2335 datë 02/06/2023 ankuesi është sistemuar përkohësisht në pozitën: "Zyrtar i Lartë për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv", në Divizionin për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv/MPJD, duke filluar nga data 02/03/2023.

Kundër Vendimit me numër reference: 191/2023 të datës 02.06.2023 të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesi më datë 02.06.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozita e Ligjit Nr. 06/L-114,për Zyrtaret Publik dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe duke i propozuar Këshillit që të nxjerrë vendim dhe ta aprovoj ankesën në tërës si të bazuar, sepse vendimi i lartcekur është i padrejtë dhe se e dëmton profesionalisht dhe ekonomikisht.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 09.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje ne ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa

me datën 09.06.2023 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Divizionit për Burime Njerëzore ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën, A.nr.821/2023 të datës 07.06.2023 me numër protokoll 4621/2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr.Ref: 339/2023 i datës 31.05.2023 me numër protokoll 2294 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimi me Nr. 191/2023 i datës 02.06.2023 i Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Email i datës 31.05.2023 i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Përgjigjeje në kërkesë me datën 09.06.2023 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Divizionit për Burime Njerëzore; Përshkrimi i detyrave të punës për Zyrtar i lart për arkiv i datës 17.04.2015; Akt Emërimi i ankuesit me nr.Akti:192 i datës 16.01.2017; Email i datës 01.06.2023; Email i datës 02.06.2023; Vendimi me A.nr.673/2022 i datës 26.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës; Vendimi me A.nr.436/2020 i datës 04.02.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 12.06.2023 nga ankuesi për plotësim të ankesës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar lëndën e ankuesit dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore që ankesa e ankuesit të kthehet në *rishqyrtim* duke e obliguar Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që rastin e ankuesit ta trajtoj në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 02.06.2023, me numër protokoll Nr.Ref.191/2023, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesin e ka sistemuar përkohësisht në pozitën „Zyrtar i Lartë për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv“, në Divizionin për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporë, këtë e ka bërë duke bazuar në nenin 4, pika 2.5, të Ligjit Nr. 06/L-114, për Zyrtaret Publik, por në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114, për Zyrtaret Publik, ku përcaktohet se: *“1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtë kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve”*, prandaj Kolegji për shqyrtim e ankesave ka konstatuar se Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk e ka përcaktuar saktë se sa do të zgjasë transferimi i nëpunësit civil, por vetëm e ka sistemuar përkohësisht në pozitën *“Zyrtar i Lartë për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv”*, e që është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 02.06.2023, me numër protokoll 191/2023, vendimin e ka nxjerr edhe në kundërshtim me nenin 47, paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, të Ligji Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kundërshtim me nenin 48, paragrafi 2 të Ligji Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“2. Një arsytim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënëses apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi i datës 02.06.2023, me numër protokoll Nr.Ref.191/2023, i Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është në kundërshtim me nenin 4

paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit"*, po ashtu paragrafi 4 i nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë përcakton se : *"Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit."* kështu që duke marr parasysh dispozitat ligjore të lartcekura Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është i obliguar të rishqyrtoj rastin e sistemit të ankuesit dhe të njëjtin ta bëjë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.821/2023.

Kaltrina Abdullahi-PRENAJ

Zyrtare e Lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së